



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

Datë 09.02.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR PËR TRAJTIMIN E GRAVE/VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE TË PAJISUR ME URDHËR MBROJTJE, ME STREHIM TË MENJËHERSHËM.

Baza ligjore:

Neni 122 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me ligjin nr. 104/2012, Direktivës (BE) 2024/1385, datë 14.05.2024, të ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për Banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me Kosto të ulët”, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqes familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, Vendim i Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 21.05.2024 “Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e procedurës së përshpejtuar për trajtimin me strehim të menjëhershëm dhe/ose subvencionim qiraje të grave/viktimave të dhunës në familje, të cilat ndodhen në situatë

rreziku ose nevojë emergjente për strehim, bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe nevojës sociale, të kryer nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale të bashkisë Durrës, të pajisur me urdhër mbrojtjeje nga gjykata.

2. Procedura e përshpejtuar dhe masat e strehimit/subvencionimit zbatohen si masa mbrojtëse, parandaluese dhe riintegruese, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) dhe Direktiva (BE) 2024/1385, duke garantuar akses të menjëhershëm dhe efektiv në shërbime mbështetëse, pa barriera procedurale apo kushtëzime disproporcionale.
3. Subvencionimi i qirasë miratohet për aq sa është parashikuar në urdhërin e mbrojtjes, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj, referuar kritereve ligjore parashikuar në ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fonde të buxhetit të shtetit dhe të buxhetit të bashkisë Durrës.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Impakti social/grupet që preken:

Gratë/viktimat e dhunës në familje, të cilat ndodhen në situatë rreziku ose nevojë emergjente për strehim në territorin e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, u mbledhë më datë 09.02.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 9 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetari i komisionit u shpreh për hapjen e mbledhjes dhe pyetjen e diskutueshme nëse ka pyetje dhe kështu mbipikën nr.9. Anëtarët nuk kishin mënjëherë në lajme. Pika nr.9 u votua pro.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

- | | | |
|---|------------|-----------------|
| 1 | Kryetar | Marsida Feshti |
| 2 | Zv/Kryetar | Sami Osmani |
| 3 | Sekretar | Joniada Musaraj |
| 4 | Anëtar | Dorian Isaj |
| 5 | Anëtar | Elisabeta Mataj |
| 6 | Anëtar | Flutura Kasa |
| 7 | Anëtar | Edlira Shemsi |
| 8 | Anëtar | Kontjana Kuçi |
| 9 | Anëtar | Erald Dalipi |